

BIBLIOTEKA

BJH-1

. Q 66

DHORI QIRJAZI

Kuz zemta  
ztesh se pazi...

Lirika

20

5

98-102

TIRANË, 1958

DHORI QIRJAZI

35642

22768

R

BIBLIOTEKA E SHETIT  
GJIROKASTER

8A-1  
Gi 66

*Kur zemra rreh së pari...*

LIRIKA

TIRANË, 1958

Redaktor: N. JORGAQI

---

Tirazhi: 1.000

Stash: 2204-55

---

Shtypur në Stabilimentin «MIHAL DURI» — Tiranë, 1958

## GJURMAT

Rri mendoj... Përjashta drurët  
i rreh era, bën tufan,  
në zjarrishtë ndizen urët,  
në dritare lot një xham;  
fill i vetëm jam në dhomë  
shkruaj vargje. Si vegim  
kalëruar shoh Heronë  
malesh nget e sokëllin!

Ja, më ngjan se rreh me shpatë  
mbi të artën yzengji,  
ndërsa kali lelegjatë  
zhduket grykash si veri.  
Dhe stërgjyshët kordhëtarë  
varg e varg i shkojnë pas,  
er' e vjeshtës duke ngarë  
pelerinat u ngre pas...

Për betejë bie briri  
edhe trupin të rrënqeth,  
dridhen malet ndaj të gdhiri  
dhe luginat rreth e rreth...  
turren trimat mbi bregore,  
përgut tutje si një hon,  
edhe shpata mbi tabore  
e gjakosur vringëllon!

Dhe Ay në majë fare  
përmbi shkëmbin mijvjeçar,  
ngre të rëndën përkrenare  
sheh kufoma, gjak e zjarr  
kryethinjur leshlëshuar;  
ndërsa kali perçezi,  
shfryn i ndezur i tërbuar  
përmbi ushtat mizëri.

E si pret e grin pa masë  
mbi të huajën hordhi,  
i flet kalit lelegjatë,  
i flet kalit perçezi,  
dhe doriu i harbuar  
u vërsul porsi rrufe  
dhe nga pirgu, shkumbëzuar,  
u hodh lart e ra përdhe!

Dhe ku shkeli në ata gurë  
gjurmën la e u nis tej <sup>(1)</sup>...  
u drodh pylli plot me drurë,  
u drodh' ujrat në lumej,  
u ndal era e tërbuar,  
u ndal shqipja në ajri,  
ndërsa trimi kalëruar  
ngjitej grykash përsëri...

Shkuan vite qysh ahëre,  
shkuan shekuj, miqt' e mi,  
që kur malesh me potere  
shkoi e Tija ushtëri,

---

1) — Në Mat diku është dhe sot një gjurmë kali skali-  
sur mbi një shkëmb, që i thonë «Gjurm' e kalit të Skën-  
derbeut».

por atje përmbi rrëpirë  
gjurm' e kalit është' dhe sot,  
gjurm' e kalit perçengrirë  
e të madhit Kastriot.

Vjeshtë, vjeshtë; jashtë era  
i rreh drurët, bën tufan;  
në zjarrishtë ndizen urët  
në dritare lot një xham;  
gjindja ra në ëndërrime  
mua gjumi nuk më zë,  
era fryn, oh, sa kujtime  
ndjell un sonte një nga një.

Ish kështu e fundit vjeshtë...  
frynte erë dhe tufan;  
në katundin tim të thjeshtë  
ndjeva hapin partizan,  
dollëm rrugës të shikonim  
rrugët zbardhnin plot me gas,  
ata shkonin e këndonin,  
rrugës gjurma linin pas...

Kishte rënë bor' e parë  
kishin ikur zogjtë larg;  
ata ecnin të pandarë  
prapa kodrash varg e varg;  
ne i shihnim të gëzuar,  
(rruga zbardhte plot me gas)  
ata shkonin e këndonin  
rrugës gjurma linin pas...

Vjeshtë, vjeshtë! Er' e rreptë  
turret shtigesh shpat më shpat,  
zjarri digjet qet' e qetë  
jam në dhomë fillikat,

prap ndjej marshe, rri pa gjumë  
rrug' e gjurma përsëri...  
un' mendoj... edhe çdo gjurmë  
më rrëfen një histori!

---

## B A L T A

Prap erdhi vjeshta... shi dhe erë...  
rrëket' e pyllit prapë erdhë,  
përbalte rrugët dhe një herë  
o balt' e verdh', o balt' e verdhë!

Të sjell ndërmend baltë... baltë...  
kur shkuan trimat armët ngjeshur,  
i ndoqe pas me dit' me natë,  
u qulle këmbët gjysmë çveshur...

Me ta ti fjete në llogore  
kur bor'e ngrirë thurte flokët,  
me ta u shkrive ndër kasolle,  
me ta dhe kur mbulove shokët.

E gjakn' uritur, ah ti thithe  
rrëket nga plagët kur u derdhë,  
po sa e dashur për ta ishe  
o balt' e kuqe, balt'e verdhë!

---

## M A L E T

«Dikush më tha një ditë duke qeshur:  
i dua fushat e blerta pa kufi,  
s'i dua malet gjithnjë me mjegull veshur,  
se ku ka male ka dhe varfëri.»  
«Po t'ish kështu o male s'do t'ju doja,  
po un' ju dua, ju dua pse e di:  
se ku ka male ka edhe shqiponja,  
se ku ka male ka dhe krenari!»

---

## PËR G J I G J A

Hej thëllënç' e malit  
fushës na ka dalë  
ku kalon një lumë,  
me të rreptat valë,  
pa më ngjitet lart  
nëpër gjetherina,  
ku bleron tërfili,  
te hapet lëndina,  
plot me trëndëlina.

Ngjitet vasha lart  
lark e tret vështrimin  
tej në ato male,  
ku përcolli trimin,  
e sjell nëpër mënd  
ditët pranverore,  
kur shetisnin bashkë  
në këto bregore:  
zënë dora-dore.



Ah, sa fjalë trimi  
vashës i pat thënë  
ndër këto lëndina  
një natë me hënë...  
tek rrinin të dyzë  
afër një mullari  
u digjej krahrori  
porsi flakë zjarri,  
oh, si flakë zjarri!

Po që atëhere  
vite kanë shkuar  
dhe sa herë vasha  
trimin ka kërkuar,  
po ay s'u kthye  
më në këto dhera...  
sa vjet e ka pritur  
moj kjo zemr' e mjera,  
oh, kjo zemr' e mjera!

Hej, thëllënx' e malit  
fushës na ka dalë  
ku kalon një lumë,  
ku buçet një valë,  
sheh si rritet gruri,  
sheh si rritet bari,  
bletën nëpër lulet  
ngjyra-ngjyra zjarri  
velur nga nektari.

I thërret djaloshit  
sa lëkunden brigjet,  
por ah, zër' i tija  
vashës s'i përgjigjet,

s'i përgjigjet vashës  
më ky zër' i djalit ...  
larg veç val' e lumit  
ç'po shkrepj pas zallit,  
haj, thëllënx' e malit!

I ka hedhur sytë,  
vetullakurorë  
nga fushat e gjera  
fushat plot traktorë ...  
diku ndër kodrina  
ku kullot një grigje,  
tek lodrojnë shqerrat  
ndër sheshe e brigje  
edhe merr përgjigje.

Dielli zuri malë,  
pyjet plot blerime,  
nëpër mënd i vijnë  
vashës sa kujtime ...  
sa vite kaluan  
me shi e shtërgatë,  
sa eshtra u tretën  
në një pyll të thatë,  
oh, bujkesh e ngratë!

Vreshtat janë veshur  
gjethet po blerojnë  
edhe zogjt' e qiellit  
bukur ligjërojnë,  
po vilastar i prerë  
shumë pat lotuar  
si bujkesh' e gjorë  
që ia dredh aq shtruar,  
zëmërpërvëlur ...